



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

**Bordi i Administrimit**

Nr. 3942 prot.

Shkodër, më 17. 11 .2021

**V E N D I M**

Nr. 345, datë 17. 11 .2021

**"PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE TË DOKTORATËS "**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në mbështetje të kërkesave të VKM nr.185 datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL të ndryshuar dhe Udhëzimit të MASR nr.7 datë 31.03.2021 "Disa ndryshime në udhëzimin nr.1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" të ndryshuar, vendimin e senatit akademik nr.239 nr.2295 prot. datë 22.07.2021 Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 16.11.2021,

**Vendosi**

1. Miratimin e projekteve kërkimore të doktoratave "Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm", Shkencat Mjedisore", Gjuhë Shqipe" për tu financuar totalisht nga të ardhurat e Universitetit gjatë kohëzgjatjes së programit në masën si më poshtë:
  - Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" në masën prej 2 473 000 (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë.
  - Doktoratë në "Shkenca Mjedisore" në masën prej 19 750 000 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
  - Doktoratë në "Gjuhë Shqipe" në masën prej 9 962 000 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë ) lekë.
2. Ngarkohet Administratori për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

